



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3173 / prot.

7 +19'

Tiranë më, 14 .12.2020

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 16 , datë 14 .12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR.12, DATË
20.07.2020 “MBI RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE MES PROKURORËVE DHE
DREJTUESVE TË PROKURORISË, INFORMIMIN, TRANSPARENCËN DHE
GARANTIMIN E PAVARËSISË, NË PROKURORITË ME JURIDIKSION TË
PËRGJITHSHËM”**

Në mbështetje, të neneve 148 e 148/b shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 38 pika 2 shkronjat “b”, 43, 46, 48, 52 e vijues të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 24, 25 pika 2 e vijues Kodit të Procedurës Penale, të nenit 52 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 159 e vijues i ligji nr.115/2016 “Mbi organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, të nenit 132 e vijues të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë,

U D H Ë Z O J :

Në udhëzimin e përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 13, pika 3, shkronja “a”, ndryshohet si më poshtë:

“a) Veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit penal apo hetimit e gjykimit pasuror, pyetjen e të pandehurit ose të personit nën hetim dhe personave të tjerë, si dhe përshkrimin e të dhënave të marra.”

Neni 2

Neni 14, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Prokurorët informojnë drejtuesin e prokurorisë, mbi kërkesën e këtij të fundit, për ecurinë e procedimit penal apo hetimit pasuror jo më vonë se 20 ditë përpara se të vendosin përfundimin e hetimeve, shpalljen e moskompetencës lëndore apo tokësore në një procedim penal apo të kërkojnë konfiskimin ose vendosin pushimin e hetimit pasuror, në të cilin drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme ose u është kërkuar sa më sipër nga ky i fundit në momentin e regjistrimit të procedimit penal apo hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij.”

Neni 3

Neni 15, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me deklarin e fajësisë, cilësimin juridik të veprës, llojin e dënimit dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ose ligjit 10192/2009, prokurori informon drejtuesin e prokurorisë brenda 3 (tre) ditëve nga kërkesën e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do të ushtrojë apelim.”

Neni 4

Neni 17, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Prokurori informon drejtuesin e seksionit¹, mbi kërkesën e këtij të fundit, brenda kompetencave që i janë deleguar nga drejtuesi i prokurorisë në mungesë të tij, në përputhje me parashikimet e nenit 16 pika 1 të këtij udhëzimi.”

Neni 5

Neni 18, pika 1 e 2, ndryshohen si më poshtë:

“1. Prokurori i apelit që përfaqëson çështjen ose akuzën mbi ankim në gjykatën e apelit ndaj të pandehurit me masë sigurimi “arrest në burg”, informon drejtuesin e prokurorisë, mbi kërkesën e këtij të fundit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit të paraburgimit të tij.

a) Informimi bëhet me shkrim, dhe duhet të përmbajë gjendjen e gjykimit, provat e administruara, dhe nëse ka, shkaqet e zvarritjes së procesit gjyqësor.

2. Në rastet kur gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit të apelit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës, llojin dhe/ose masën e dënimit, prokurori informon drejtuesin e prokurorisë të apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do të ushtrojë rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit.”

Neni 6

¹ Shih, nenin 21 pika 2 të ligjit nr. 97/2016.

Neni 21, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit² dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit.”

Neni 7

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



² Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja “a” “b” dhe 102 pika 1 shkronjat “c” “ç”, “d” “dh”, “e”, “g”, “i”, “j”, “nj”; pika 2 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019.